



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

**NJË VËSHTRIM MBI TRADITAT E DASMAVE,
VESHJEVE DHE FOLKLORIT NË FSHATIN
GURGURICË**

Kandidat:

Afrim Jakupi

Mentor:

Dr. doc. Meral Veseli

Tetovë 2022

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE	4
Lënda e hulumtimit	5
Qëllimet e hulumtimit	6
Hipotezat	8
Metodologjia e hulumtimit	9
Metodologjia e kërkimit	10
Rëndësia e punimit	11
HYRJE	12
KREU I PARË	14
VENDBANIMET NË KOMUNËN E BËRVENICËS	14
Fshati Gurguricë	14
Demografia dhe fiset kryesore	16
KREU I DYTË	18
II. RITET E DASMES NË RAJONIN E MALIT TE THATË	18
KREU I TRETË	21
III.1 LOJRAT POPULLORE	21
III.2 NINULLAT OSE KËNGËT E DJEPIT	21
III.3 KLASIFIKIMI I KËNGËVE DHE LIRIKA POPULLORE	22
KËNGËT E DJEPIT	23
KËNGËT E DASHURISË	24
KËNGËT RRETH GRABITJES SË VAJZËS	27
KËNGË PARAFEJESE	27
KËNGË KUR MERRET RRIJJA	32
KËNGË FEJESE	33
KËNGA KUR PRITEN PETKAT	37
KËNGËT KUR DËRGOHEN PETKAT	38
KËNGËT E VAJIT TË ÇIKËS	40
KËNGËT E DITËS SË DASMËS	41
KËNGËT KUR ARIJNË KRUSHQIT NË SHTËPINË E NUSES	50
KËNGA E LARGIMIT(NISJES) TË KRUSHQIVE	52
KËNGA E KTHYERJES SË KRUSHQËVE	53

KËNGA E NUSËRIMIT	55
KËNGËT E SOFRËS	57
KËNGËT E BULLAVE (PËRQESHJA E NËNËS DHE BABAIT TË NUSES)	58
KËNGËT E SYNETISË	60
KREU I KATËRT.....	63
IV. VESHJA E GRAVE NË FSHATIN GURGURICË	63
IV.1PUNIMI I VESHJEVE	65
IV.2 VESHJET DHE PREGADITJET E NUSËRISË.....	66
INTERVISTA.....	84
FJALORTHI	85
PËRFUNDIM	86
LITERATURA	87

MIRËNJOHJE

Dëshiroj të falemnderoj dhe të shpreh mirënjohjen time të thellë për mentoren, doc.dr Meral Shehabi Veselin, e cila më ka ndihmuar në mënyrë të pakursyer me profesionalizmin të lartë akademik në përzgjedhjen e temës me interes nga etnolinguistika, si dhe për udhezimet gjatë gjithë kohës së punimit të kësaj teze masteri. Gjithashtu, falemnderoj edhe profesoreshën, doc.dr Lujeta Adili-Çelikun, që më nxiti në zgjedhjen e temës dhe që më ndihmoi në strukturimin e saj. Të dyjave u jam mirënjohës për konsultimet e vazhdueshme, sugjerimet që më kanë dhënë, për literaturën që më kanë sugjeruar ta përdor, si dhe shpjegimin e paqartësive e pyetjeve të cilat më lindën gjatë punimit të kësaj teze. Falemnderoj edhe profesor Zeqir Kadriun për ligjëratat gjatë studimeve të ciklit të dytë dhe për sugjerimet e tij rreth tezës së masterit.

Faleminderime të sinqerta deri te Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe pranë Fakultetit të Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit në UEJL, për miratimin e kësaj teze masteri. Mirënjohje për krejt bashkpunëtorët e mi për mikpritjen, të cilët nuk kursyen kohë gjatë intervistave dhe që më kanë dhënë ndihmë sa herë i vizitoja me materiale e me foto të ndryshme. Faleminderim dhe mirënjohje të pakufishme edhe për familjen time, të afërmit e mi të cilët më nxitën, më përkrahën pa rezervë gjatë gjithë kohës duke më inkurajuar vazhdimisht duke më ofruar gjithë hapësirat e nevojshme për t'ia dalë mbanë në realizimin me sukses të këtij punimi.

Ju faleminderit nga zemra!

Lektoroi:

Luljeta Adili-Çeliku

Lënda e hulumtimit

Me kërkimin, studimin dhe botimin për folklorin shqiptar dekada me radhë nuk është marrë asnjë. Në këtë drejtim nje kontribut të madh në fusha e folklorit do të japë prof.dr. Mustafa Ibrahim - me vëllimet “Thesari folklorik shqiptar nga rajoni i Pelagonisë”, ”Gjuhë dhe kulture” të botuar në vitin 2003. Me vonë një kontribut të veçantë në këtë drejtim do të japë edhe prof.dr. Vebi Bexheti me studimin “Veshalla nëpër shekuj”. Një studim mbi folklorin ka dhënë edhe studiuesi Agron Xhagolli me botimin “ Folklori shqiptar në bashkëkohësi”

Një studim kërkimor përshkrues dhe ilustrues nga fusha e etnolinguistikës ka bërë autorja Edibe Selimi Osmani në dy vëllimet e saj me titull: “ Veshja autoktone e femrave të Rekes së Eperme”, 2012 dhe “ Veshja autoktone e meshkujtve të Rekës së Eperme”, 2014.

Ngelet si detyrë ta ruajmë këtë trashëgimi, dhe mbi gjurmat e tyre të vazhdojmë mbledhjen dhe studimin e folklorit edhe më tutje, sidomos në këtë pjesë të Malit të Thatë, duke e vetëdijësuar popullin dhe gjeneratat e ardhshme, pasi një pjesë e këngëve popullore, riteve, dokeve që janë të pranishme në gojën e popullit ende nuk janë mbledhur. Pra, duhet të krijohen kushte ku do të jenë të gjitha mundësitë për ta mbledhur në mënyrë më të organizuar e në shkallë më të gjerë folklorin e popullit tonë.

Lënda e hulumtimit e këtij punimi të magistraturës do të jetë mbledhja dhe studimi i folklorit në vendbanimin shqiptar të kesaj pjese të Malit të Thatë, gjegjësisht në fshatin **Gurguricë** të komunës së Bervenicës, një fshat etnikisht i pastër shqiptar.

Puna ime e përditshme në këtë fshat si arsimtar, duke parë traditat, doket, zakonet, dasmat, se si me aq dashuri i kultivojnë, me shtyri që të mbledh dhe të nxjerr në pah diçka më tepër rreth kësaj fushe, duke mbledhur dhe i studiuar gati dy vite.

Qëllimet e hulumtimit

“Një vështrim mbi traditat e dasmave, veshjeve dhe folklorit në fshatin Gurguricë” është një studim i cili shpreh origjinalitetin e vlerave etnokulturore të popullatës shqiptare të kësaj pjese të Malit të Thatë, me të vetmin qëllim që të mblidhet materiali, të sistemohet dhe studiohet në çdo aspekte, sepse siç thotë një proverbë popullore “*me vdekjen e një plaku vdes edhe një pjesë e kulturë së trashëguar*”.

Qëllim i këtij hulumtimi kërkimor është mbledhja e thesarit popullor, si: tradita e dasmave, tradita e veshjes së grave, këngët e ndryshme që lidhen me tradita dhe zakonet e ndryshme të fejesës, martesës, dashurisë, ceremonitë e dasmës etj.

E gjitha kjo pasuri folklorike duhet të mblidhet e të sistemohet pasi ato zhduken nëse nuk ruhen, sidomos me mbarimin e jetës së një plaku. Gjithashtu, nuk duhet të harojmë, se edhe atë material që kemi, ka mangësi të ndryshme, siç janë përshkrimet e gabuara dialektologjike. E gjitha kjo mund të arrihet dhe të korrigjohet, me mbledhjen e saktë të këtij materiali, duke u përqëndruar edhe në disa rregulla gjuhësore dhe dialektologjike. Kërkimi i materialit folklorik dhe mbledhja e tij, kërkon kyçje të një numri më të madh studijuesish të kulturës dhe etnografisë shqiptare. Gjatë mbledhjes së folklorit duhet të kemi parasysh dy fusha kryesore të kërkimit në botën shpirtërore dhe botën materiale

Qëllimi i kësaj teze magjistrature është që përmes këtij hulumtimi t’u përgjigjet pyetjeve :

- Ku shtrihet ky venbanim i quajtur Gurguricë dhe cili është historiku i tyre?
- Si bëhen dasmat, dhe cilat janë ceremonitë dhe zakonet në fillim të dasmës dhe mbarim të dasmës?
- Cilat këngë dashurie janë kënduar?
- Mbledhja dhe regjistrimi i këngëve të dasmës?
- Zakonet që përdoren gjatë marrjes dhe mbylljes së nuses?
- Mbledhja e këngëve që ka të bëjë me fazat e dasmës?

- Studimi i këngët dhe ceremonitë e dasmës?
- Hulumtimi i lojërave popullore dhe prejardhja e tyre?
- Te hulumtohet veshja tradicionale e grave?
- Të hulumtohen qëndisjet e vjetra popullore?
- Të hulumtohen enët e vjetra që janë përdorur?
- Të hulumtohen gatimet e ndryshme etj.

Hipotezat

Çdo studim kërkimor shkencor kërkon punë serioze duke u mbështetur në fakte reale dhe me prova në terren, mirëpo ndodh që vlerësimet të bien ndesh me problemet të natyrave të ndryshme, dhe vlerësimet të jenë të pa rëndësishme, andaj në këtë studim do të paraqesim këto hipoteza:

- Folklori dhe veshja tradicionale e grave në këtë vendbanim duhet të mblidhet dhe të studiohet në të gjitha komponentët e saja e më pas mund të jepen mendime, sugjerime dhe vlerësime të ndryshme.
- Një pyetje hipotetike është , *a ekzistojnë ende këngë dhe ceremoni në këtë fshat?* Duke u nisur nga fakti se, dasmat sot i bëjnë nëpër ambiente të mbyllura dhe vetëm një ditë, por jo 10 ditë sa zgjaste në të kaluarën .
- Dallimi i veshjeve tradicionale nga ajo e zakonshmja.
- Vallë a vazhdojnë të praktikohen të gjitha zakonet para fillimit të dasmave!?
- Të përkufizohen dhe të definohen nocionet bazë të lidhura me temën dhe lëmin e hulumtimit.
- Të theksohet roli dhe rëndësia që ka në shoqërinë bashkëkohore dhe kjo tezë magjistrature .

Metodologjia e hulumtimit

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës së nevojshme.
2. Përpilimi i pyetësorëve.
3. Përpilimi i platformës studimore

“Një vështrim mbi traditat e dasmave, veshjeve dhe folklorit në fshatin Gurguricë.”

Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Pyetësorët për ekspeditat nga fusha e folklorit.
2. Intervistat dhe bisedat e drejtpërdrejta.
3. Materialet folklorike në kohëra të ndryshme dhe shfrytëzimi i literaturës.
4. Materiale nga fusha e folklorit, siç janë ata të besimit, moshës e gjinisë.

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Krahasimet me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën qëpërfshin mbi dhjetëra pika të grumbullimit të të dhënave për një territor më të gjerë.
2. Analiza dhe shqyrtimi sociolinguistik i folklorit, dhe veçorive fonetiko-gramatikore, dhe duke e parë në vështrim krahasues me punime të mëparshme.
3. Shqyrtime dhe studime të thelluara për folklorin.
4. Përfundim i përgjithshëm .

Metodologjia e kërkimit

Metodologjia e kërkimit tim do të bazohet në punën time të përditshme në këtë fshat, takime me njerëz të ndryshëm dhe shfrytëzimin e të gjitha mundësive për të mbledhur dhe sistemuar lëndën nga fusha e folklorit. P.sh. në bisedat e zakonshme në familje në dasmat e festat tjera, vdekjet e vajtimet etj. Na dërgojnë në zbulimin e fjalë e shprehje të vlefshme. Gjatë takimeve të ndryshme, bashkëbiseduesit, duhet të jetë vendas dhe të përfaqësoj vërtetë të folmen e krahinës së këtij vendbanimi; të bisedojnë lirshëm dhe që kanë shqiptim të rregullt; duhet të zgjidhen nga të dy gjinitë, dhe nga të gjitha moshat dhe sipas fushave të veprimit. Personat më të moshuar zgjidhen për fushat siç janë: ngjarje e dukuri dhe kujtime nga e kaluara, ndërsa për gatim gjellësh, për punëdore, zgjidhen gra që janë marrë gjatë kohë me këto punë. Për lojra dhe lodra të ndryshme zgjidhen edhe fëmijë e fshatit etj.

Intervista me bashkëbiseduesin mund të bëhet me dy metoda:

- a) Metoda e bisedës së lirë, për të shtyrë atë të shprehë mendimet e ndjenjat e veta, përshtypjet dhe bindjet që ka. Në fillim të bisedës me bashkëbiseduesin flasim lirshëm, pa mbajtur shënime, mundoheshim që bisedën ta bënim të ngrohtë, e ta gjallëronim duke i hequr çdo ngurim e duke i bërë të qartë edhe qëllimin e punës sonë.
- b) Metoda e pyetjeve dhe e përgjigjeve.
Për të mbledhur leksikun zakonisht përdoret kjo metodë, siç janë: emrat, të mjeteve, sendeve, të veshjeve, të veglave e orendive të ndryshme etj. Emërtimet duhet të nxirren gjatë bisedës me bashkëbiseduesin, e jo pyetja të përmbaj emërtimin ose gërshetimi i të dyja metodave.

Rëndësia e punimit

“Një vështrim mbi traditat e dasmave, veshjeve dhe folklorit në fshatin Gurguricë.” është një punim shumë i rëndësishëm pasi krijmtaria popullore, sidomos folklorin pasi dasmat, e në veçanti veshja e grave të fshatit, paraqesin thesarin popullor duke pasqyruar: historinë, doket, ritet mentalitetin, besimet etj. Kjo krijmtari është e nevojshme për t’iu kundërvënë ideologjisë së huaj, e cila mohon të gjitha vlerat etnike kulturore e folklorike dhe ekzistenciale të një populli, ndërsa me publikimin e folklorit bëhet afirmimi i këtyre vlerave të popullit tonë.

Ritet dhe doket e banorëve të këtij fshati të rajonit të Malit të Thatë, paraqesin një thesar të begatë kulturorë, jo vetëm për kulturën dhe identitetin shqiptar, por edhe një mjet kundër asimilimit të tyre.

Ky fshat ka arritur t’i ruaj me një xheloz të madhe jo vetëm gjuhën, por edhe doket dhe zakonet e dasmave, që u kushtohet rëndësi e madhe, sidomos në familjen e dhëndërit. Dasmat dikur bëheshin 7 deri 10 ditë (prej të dielën deri të dielën), kurse sot bëhen 1 ditë.

Ky punim magjistrature do të prezantojë historikun e shqiptarëve të kësaj ane të Malit të Thatë dhe folklorin e tyre, por edhe ruajtjen e këtij thesari i cili në heshtje shkon drejt zhdukjes së sigurtë.

HYRJE

Në këto anë të Malit të Thatë, studimet mbi folklorin janë të mangëta kur bëhet fjalë për studime të mirëfilta mbi folklorin dhe të folmet dialektore, mbi ritet e dasmave, zakonet, veshjet lojrat popullore etj.

Ky punim kërkimor shkencor do të trajtojë dasmën dhe të gjitha ceremonit e saj, duke filluar nga këngët e dasmës, dhe mënyra se si bëhen dasmat, urimet e zakonshme të kësaj treve në lidhje me gëzimet familjare, të folmet krahinore, që dallojnë nga trevat tjera si dhe veshjet e grave dhe burave. Në këtë vendbanim, martesat bëhen kryesisht brenda fshatit dhe në mes fshatrave për rreth (Sallarevë, Korit), sepse ky vendbanim gjendet në një largësi afër 40 km nga qyteteti i Tetovës.

Tash vërehet një ndryshim me shkollimin e femrës, në të kaluarën martesat u kryeheshin mrenda fshatrave, por tani kjo rregull nuk ekziston . Tani, vajzat e këtij lokaliteti, martohen në vende të ndryshme, qoftë në fshat apo në qytete si Tetovë e gjetiu. Ndarja e vades është një akt që kryhet pas fejesës

Fjalet apo uratat që shkëmbehen me rastin e martesave janë të ndryshme p.sh: “për hajr martesë e djalit ” dhe vijon përgjigjja e mikut “mender qofsh e hajr paç”, “urime dasma ” kurse të gjeneratat e reja urimet janë me të ndryshme, si p.sh. “urime”, “u trashëgofshi” etj. Deri para disa vitesh dasmat zgjasnin shtatë ditë, ndërsa kohëve të fundit ato janë reduktuar në dy-tre ditë, apo vetëm në një ditë dhe kryesisht bëhen verës.

Në të kaluarën kur beheshin dasmat u caktohej vendi se ku dhe kush do t'i mirëpresë mysafirët , kurse tash ahengjet familjare bëhen në restaurante . Disa ditë para se të fillonte dasma mblidheshin bijat e fisit, (vajzat e martuara, motra, halla e dhëndrit),e çonin drithin në mulli. Bënin pregaditjet dhe ndarjet e punëve përgatitore për dasmë. Caktoni personin që do merret me pregaditjen e ushqimit të gratë (magjatoren) dhe të burat (kuari-gjellbërësi). Magjatorja: e kishte për detyrë të merrej me gatimin e bukëve, piteve (ndredhijave) dhe gjërave tjera, pra caktohej një grua e fisit në rolin e magjatores. Te burrat caktohej një pergadites ushqimesh me pagesë nga fshati që do pergadiste ushqim për dy-tre ditë për tërë fshatin. Në të kaluarën dasma ka pasur karakter më të gjerë u mblidhte i gjithë fisi. Gëzimi ka qenë më i madh ashtu si e përshkruajnë të intervstuarit e mi. Të gjithë të ftuarit kanë qenë në lidhje me familjen e dasmorit.

Në të kaluarën dasmat organizoheshin një ditë për burrat, kurse ditët tjera për gratë. Përgatitej ushqim dy ditë për tërë fshatin si te burrat ashtu edhe te gratë.

Për dasmat banorët kur bisedonim shpreheshin : “ *Kur ka dasma këtu, ka festë*” , kjo është një dëshmi se sa madheshtore dhe sa vlerë kanë qënë dhe janë dasmat.

Për burrat përdorin instrumentet muzikore, si: defa, tupana e zurle, kurse në mbrëmje muzikë nga estrada, por nuk mungojnë edhe grupi i valltarëve dhe i çifteliave tek oda e burrave. Te grate dasma kryesisht zhvillohej me daullet, dhe me me def, duke hedhur valle. Kurse kohëve të fundit vërehet një tendence (për fat të keq) edhe stilit të muzikës i ashtuquajtur “tallava”, një muzikë ritmike pa vlera .

KREU I PARË

VENDBANIMET NË KOMUNËN E BËRVENICËS

Komuna e Bërvenicës shtrihet në veriperëndim të Maqedonisë së Veriut, dhe në fushgropen e Pollogut. Në të gravitojnë fshatrat, si: Çellopeku, Miletina, Radiovca, Sedllarca e Poshtme, Bërvenica, Gurgurica, Stençe, dhe Vollkovia. Në Komunën e Bërvenicës¹ jetojnë 13.645 banorë residentë, ku shqiptarë janë 7377 nga numri përgjithshëm, maqedonë 5715 banorë dhe pjesa tjetër u përkasin nacionaliteteve tjera, pra shumicën e popullsisë në këtë komunë e përbëjnë shqiptarët.

Fshati Gurguricë

Rajoni i Malit të Thatë shtrihet midis tri qyteteve: Tetovës, Makedonski Brodit dhe Gostivarit, përfshin rrjedhën e epërme të lumit Treska (Ilirida). Në shpatet e lumit gravitojnë disa fshatra shqiptare. Njëri nga këto fshatra është edhe Gurgurica.²

Fshati gjendet në një lartësi mbidetare mbi 1400 metra në juglindje të Tetovës, familjet e para që u vendosën në këtë vendbanim ishin familje të ardhura nga Reka e Epërme dhe datojnë që nga viti 1519. Çdo vend ka një emër të krijuar mbi baza bindëse shpesh me ngjarje që kanë ndodhur nga pushtuesit e huaj të tokave, agallarë e bejlerë që disa vendbanime i kanë quajtur si çifigje. Disa vendbanime janë quajtur edhe sipas ndërtimeve të vjetra, por edhe në bazë të formave të relievit etj. Etimologjia e fshatit Gurguricë, si toponim mendohet që i është dhënë sipas relievit që ka “Gurishtë”, “Gur”, “Gurë mbi gurë” prej nga edhe e ka marrë emrin Gurguricë.

¹ Në bazë të dhënave nga Entit për Statistikë në R.Maqedonisë së Veriut ,2021

²Gurgurica në vitin 1894 i takonte Vilajetit të Kosovës dhe bënte pjesë në Kazanë e Tetovës,në rregjistrimet osmanet të asaj kohe njihej si “Nahi”.

Ekzistojnë edhe mendime e hipoteza tjera për prejardhjen e emrit Gurguricë

- Antroponimi në onomastikën e regjistrave kadastrale osmane te shek. XV: Goradaglik –Malësi, që ka një kuptim etimologjik Gurguricë;
- Si emër Krekonica – Gurgurica e përmend edhe autori bullgar (Vasil Kënçev) në librin e tij, në vitin 1467 ky fshat numronte 12 shtëpi.
- *“Emrin Gurguricë e gjejmë edhe në mesjetë që ka qenë Grogorius i cili ishte i vendosur në krye të papatit të Romës, Ku territori Perandorisë Romake arrintederi te një pjesë të fshatit Gurguricë” (E.Mersimi, 2012, f.20)* Mendohet se disa vendbanime të këtij fshati si “Bunaret” “Stanet” , “Shtrunga “ janë më te vjetrat e këtij lokaliteti (830 vite) i takon periudhës së sundimit romak.

Fshati ndodhet rreth 40 kilometra larg Tetovës. I vendosur në maje e Malit të Thatë, fshati ofron një panoramë të mrekullueshme të Liqenit nga njëra anë dhe Luginës së Pollogut nga ana tjetër. Në bazë gojdhënave *thuhet se:” fshati Gurguricë është shumë i lashtë dhe gjatë kësaj periudhe, është shkatërruar tri herë; dy here është djegur dhe një here është shkatruar prej sëmundjes lija”*.

Banorët e Gurguricës kanë përjetuar “ ferr” gjatë luftërave. Ato u ballafaquan me pushtues të ndryshëm, si me : italianët, partizanët-komunistët etj. Gjysma e fshatit (e njohur si shtrunga) ishte në sundimin italo-shqiptar e gjysma tjetër nën sundimin bullgar. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botrore, banorët e Gurguricës panë ferrin e vërtet nga çetat komuniste srbo-sllave. Nga presionet e vazhdueshme, si në shumë vise tjera, edhe në këtë fshatë shumë familje u detyruan të largohen për të mos u kthyer kurrë.

Banorët janë shumë mikpritës, burra të fjalës e të besës, ata kanë të vetmin qëllim që fshati ta shëndrojnë në një vend atraktiv turistik, duke pasur parasysh relievin që ka dhe peizazhin që jep liqeni i Treskes, liqenin të cilin banorët e thërasin sipas emrit të vjetër, Liqeni i Iliridës.

Demografia dhe fiset kryesore

Vendbanimi i quajtur Gurguricë, në bazë të dhënave nga enti për statistikë (2021) numëron diku 300 shtëpi dhe 2000 banorë. Në të kaluarën fshati merrej kryesisht me blegtori, dikur fshati numëronte 22.000 copë dele e 700 krye lopë siç shprehen banorët. Arsyeja e migrimit të gurguricasve ka ardhur si rezultat i mosinvestimeve dhe ndryshimeve shoqërore, Jeta e vështirë i ka detyruar të migrojnë për një jetë më të mire, tash fshati është shëndru në një fshat kryesisht mërgimtarësh. Në bisedë me fshataret e Gurguricës ato shprehen se ka edhe dy fshtra si Gurgurica të cilët janë shpërgulur në Pollogun e Poshtëm e gjetiu.

Për fat të keq vërehet një trend në ritje për migrim të brendshëm të banorëve të këtij fshati, në qytet apo në fshatrat për rreth. Fshati po boshatiset në “heshtje” .

Gurgurica gjatë viteve 1878 deri vitin 1912 i takonte vilajetit të Kosovës, bënte pjesë në Kazan e Tetovës që njihej si “ Nahij”. Fisi apo familjet e para që u vendosën në këtë vendbanim është fisi i Tahir Bylikbashit aty ka viti 1843 me djemtë e tij Jahja, Meta, Hesati dhe Kasami, mendohet se ishte nga Rimnica³. Ai e gjeti fashatin të pabanuar por hasën shumë objekte banimi (si shtëpi, kasolle, vathe) dhe vegla të ndryshme pune që tregon se ky vendbanim ka qenë i banuar që më parë.

Banoret shprehen se “Kasam Qehaja⁴ ishte djali më i vogël i Tahir Bylikbashit dhe me vendosjen e tyre në Gurguricë, i ati të gjithë pasurinë ja kishte besuar ati si më i afti nga djemtë. Nga i ati Kasam Qehaja kishte trashëguar 300 dhen, por arriti ta shtojë pasurin e tij deri në 12.000 dhen, 100 lopë dhe rreth 300 kuaj”. Kasam Qehaja zotronte një territor prej 213 km² , ku përfshihej territori Gurguricës, Breznicës dhe Rudinës. Ishte një nga njerëzit më me ndikim të asaj kohe, mbante lidhje të ngushta me Abdyrahman Pashanë e Tetovës, i besuari i Perandorisë Osmane për mbykqyrje teritoriale administrative.

³ Rimnica shtrihet në pellgun e sipërm të lumit Radika në jugperëndim të Gostivarit, .Fshat malorë që shtrihet në lartësi mbidetare 1010 m, me ndarjen teritoriale të vitit 2004 i takon Komunës së Rostushës.

⁴Fjalori gjuhës së sotme shqipe (shih fq.1591) për fjalën qeha-qehaja-qehallarët jep këtë kuptim Kujdestar të pasurisë së një beu,agai ose të një pronari tjetër.Qehaja i beut.Qehajq i esnafit qi që përfaqsonte marrëdhëniet e ndryshme me të tjerët.

Fiset tjera që do vendosen në këtë fshat malor të Malit të Thatë janë: Rexhallarët, Nurdinallarët, Kacanallaëret, Honxallarët, Hojkallarët, Bajrallarët, Babuçallarët. Biballarët (nga fshati Bibë i Rekës së Epërme), Idrizallarë , Qazimallarët etj.



Pamje e fshatit Gurguricë

KREU I DYTË

II. RITET E DASMES NË RAJONIN E MALIT TE THATË

Një vend të veçantë në jetën e banorëve të këtij fshati zë padyshim dasma dhe me të drejtë banorët e këtij vendbanimi atë ditë e quajnë festë, pasi ftohet i gjithë fshati. Ritet e dasmës, në veçanti në Gurguricë, kanë një traditë të hershme të kultivuar me shekuj që ka arritur ta ruaj me shumë dashuri traditën dhe kulturën shqiptare të kësaj ane. Dasmat ndodhin zakonisht gjatë muajve të verës kur ka një numër shumë të madh të banorëve se është kryesisht një fshat mërgimtarësh dhe gjatë muajve të verës kthehen në familjet e tyre. Pra, dasmat bëhen zakonisht të enjten dhe të dielën sipas riteve e traditave që ruhen me shumë dashuri.



Në foto janë krushqit e një dasme

Ajo që bie në sy në dasmat e këtyre trevave dhe që e bën edhe më madhështore atë është mënyra e marrjes së nuses. Krushqive u prinë dy burra para bajraktarit, kurse krushqit tjerë vijnë në këmbë. Dasmori u ndanë të gjithë krushqive nga një plis, një brez dhe nga një bajrak (për të parin e krushqive) gjë që e simbolizon prezencën e riteve kombëtare dhe identitetin shqiptarë.

Dasmat në të njëjtën kohë bëhen edhe në familjen e djalit, por edhe në familjen e vajzës dhe kanë filluar po të njëjtën ditë, nga hëna dhe zgjat deri të dielën.

Dita e parë e dasmës është e njohur si dita e Unazës. Luajnë, këndojnë me defa e valle. Më pas shtrohet unaza e cila vëndoset mbi një sofër të një dhome. Në “sofrën e unazës” vendosen 15 shami me ngjyra të verdha të njohura si korpa(shamia). Pra, simbolika e kësaj dite është se mblidhen të gjitha gratë e fisit e më gjerë për të uruar dasmën për ditën e unazës.

Dita e dytë apo e njohur si dita e petkaxhive. Në këtë ditë dërgohen teshta e nuses, pra shkohet te miku i ri.

Dita e tretë e dasmës,është dita kur ngrihen bajrakët, pra në këtë ditë, në mëngjes herët dasmori ngre bajrakun(flamurin kombëtar) në derë të madhe, në hyrje të shtëpisë dhe cakton dy bajraktar.Të ftuarit gostiten me ushqime tradicionale si bagërdarë. Më pas vijnë tupanat e zurlet në shtëpi të dasmorit ku vallëzojnë i gjithë fisi, burra e gra. Në mbrëmje ftohet i gjithë fshati në konak të caktuar ku të ftuarve u servohet ushqim i përgaditur tradicional me kazana. Më pas shkohet në qendër të fshatit te vendi i njohur “Dakati“ ku festa vazhdon deri orët e vona të natës me muzik të zgjedhur nga estrad jonë.

Në ditën e katërt të dasmës, në shtëpinë e dasmorit mblidhen të ftuarit për të kryer edhe ceremonitë e fundit të dasmës, si rruajtja dhe heqja e flokëve të dhënderit, më pas të gjithë të ftuarve u ndahet një brez nga dasmori në shenjë respekti.

Dita e nuses, në të kaluarën nusja merrej me kuaj dhe u përcillte nga pleqt e fisit dhe u dorëzohej krushqive e mbuluar me një pëlhurë të kuqe që simbolizon traditën dhe doket e kësaj ane .Krushqive u prinë bajraktari, e pas vinin krushqit, të gjithë me plisa në kokë.

Dita e krojit, është dita kur nusen e veshin me veshje tradicionale të kësaj ane të njohur si Anteria, e nxjerrin te kroji për të mbushur uji, pregadisnin petulla këtu të njohura si tinginica. Më pas nusja në shoqëri të nuseve tjera të fisit ua merr dorën familjarëve.

Dita kur nusja fshin me netull (pastron oborrin), ditë në të cilën nusja vishet me veshje tradicionale të quajtura dymija e fshin, e pastron oborrin, dhe e dërgojnë nëpër familje të burrit.

Prerja e flokëve, një nga adetet më të vjetra, ku dhëndëri ia pret zylyfet.

Kthimi n'kalaç, kjo natë llogaritet si nata e parë e nuses te fisi, Vijnë të afërmit e nuses e marin vajzën në shtëpi të vet, të nesërmen familja e dhëndërit bashkë me dhëndërin shkojnë për ta marrë nusen.

KREU I TRETË

III.1 LOJRAT POPULLORE

Lojrat popullore në të kaluarën ishin karakteristikë e familjeve të pasura me rastin e ndonjë gëzimit familjar, martese apo synetie etj. Këto gëzime familjare organizoheshin në vendin e quajtur të “ Livadhet “ Aty të gjithë të ftuarit zbaviteshin me lojra të ndryshme, si; vrapimi i kuajve, grindja e gjelave, hedhja e gurrit, kërcim, mundje etj. Por pjesa kryesore e këtyre ahengjeve familjare ishin pelivanët. Fatkeqësisht këto tradita pothuajse nuk ekzistojnë, janë nderprerë më.



Në foto kemi dy pelivanë

III.2 NINULLAT OSE KËNGËT E DJEPIT

Ninullat janë këngë djepi ku nëna me shumë dashuri i këndon fëmijës, krijohen aty për aty, duke iu nështruar instiktit të vet amnor dhe mbizotëron ndjenja njerëzore e gëzimit të madh për lindjen e fëmijës, por vazhdimisht u praktikohete per vënie në gjumë të fëmijës. Këngët kanë një ritëm dhe melodi që korrespondon me ritmin të përkundurit të djepit, dhe vënie të foshnjës në gjumë. Vazhdim po sjell disa këngë djepi të mbledhura në këtë fshat.



Mjete tradicionale popullore

III.3 KLASIFIKIMI I KËNGËVE DHE LIRIKA POPULLORE

Klasifikimi i poezisë lirike⁵ në grupe dhe nëngrupe është shumë e vështirë sepse në të shumtën e rasteve pasqyron elemente të jetës intime personale, por edhe momente me karakter të përgjithshëm. Klasifikimet në literaturën shqiptare janë në varshmëri me nivelin e shijes aristike.

Nga Johan G.fon Hani⁶ i cili i pari bëri klasifikimin e këngëve lirike. Hani për shembull këngët lirike i ndante sipas kriterit regjional – dialektor përmbajtësor në

⁵Universiteti "Sh. Cirili dhe Metodi" Fakulteti Filologjik, Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare, Letërsia gojore shqiptare 1, Shkup 1997, f.34-35 .

- a) Këngë lirike
- b) Këngë beratase
- c) Vaje
- d) Poezi geqe

Jeronim de Rada⁷ do të përdorë kriterin e periodizimit dhe jo për klasifikim. Ndërsa Dhimitër Kamarda klasifikimin e bën sipas karakterit regional. Njëri nga mbledhësit më të zellshëm të lirikës gojore është Thimi Mitko, i cili kombinon dy kritere kriterin atë regional dhe atë përmbajtësor.

KËNGET E DJEPIT

Këngët e djepit në vete karakterizohen me një lirikë të thellë, ku mbizotëron ndjenja e fuqishme njerëzore, ku na shfaqen krahasime, hiperbola dhe figura te ndryshme mitike, thërrasin në fuqi të tjera të mbinatyrshme vetëm e vetëm që fëmijën ta zërë gjumi.

Po sjell një këngë djepi të kësaj ane të kënduar brez pas brezi, tregohet përkundja e fëmijës në djep ku nëna i thotë foshnjës se do ta risë e do ta shëtisë me kalë në livadhe, do ta ushqej me përsesh me qumsht e me dhallë.

Luli lul

Luli luli gjalin oo, do ta çaj me kalin oo

Luli luli birin oo, do ta çaj me çilin oo

Luli luli bijën oo, do ta çaj nlihtiet oo

Luli luli vajzën oo, do ta çoj nli vadhe oo

Hajde gjum ka shëtiten oo

⁶Instituti Folklorik, Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar(1635-1912),Tiranë 1960,62-90

⁷ Jeronim de Rada, Vepra 5.Rapsodi të një poemi shqiptar, Rilindja ,Prishtinë 1983

Kit Dinaren a na ritën oo
Hajde mare gjum, kah shkanë oo
Dinaren e vogël pse na harron
Hajde gjum a gjum i ambel
Do ti grij përshesh me tambël
Hajde gjum a gjum i tharët
Do ti griji përshesh me dhallet
Halluvajk mar e shkret,
Ma vish te na se s'bjm pater
Kit Dinaren e zu gjumi,
shka qeter kundi, se de përkundi

Informatori: Ilmije K .1965

amvise fsh. Gurgurice

KËNGËT E DASHURISË

Këngët e dashurisë janë një nga krijimet më cilësore të lirikës sonë popullore , një lirikë e pasur, ku i këndohet dashurisë së sinqertë lirikë kjo e ruajtur me shumë xhelozë në popull, ashtu që nuk ka mundur ta zbeh as fanatizmi, as zakonet e prapambetura të së kaluarës.

Burimi kryesor i këngëve për dashurinë, siç shihet edhe në tekstet e këngëve është fshati dhe ambienti blegtoral, bujqësor, pra e bukura e këtyre krijimeve popullore qëndron në atë se protagonistet merren kurbetçari dhe baresha. Këto këngë këndohen kryesisht, në festa familjare e dasma.

Lirim aga unis për gurbet

Muerr çantën Lirim aga u nis për gurbet

I kish rat penkalla ka njani xhep

Edhe ja ka gjet dashnorja e vet

Ja ka gjet dashnorja e vet

Edhe nuk ja jep

Nama oj dashnore ta harxhiti

O sat vi ka gurbeti do ta lyp

Nama oj dashnore ta mbushi me boj

Sa tvi ka gurbeti shkusit do ti çoj.

Duel vajza

Duel vajza në çerdak

Mori nano,mbet merak

Duel vajza në çerdak

Mori nano,mbet merak

E kish shtatin mori nano

Të gjat si bajrak

E kish shtatin mori nano

Të gjat si bajrak

Doli vajza në avli

A thu non e kam jazi

E kish shtatin mori nona

Të gjatë si Selvi

Në këto këngë i këndohet bukurisë së vajzës ku përshkruhen tiparet e saj:

E kish shtatin mori nona

Të gjatë si bajrak

E kish shtatin mori nona

Të gjatë si Selvi

Në vargjet e këtyre këngëve hasim edhe vargje ku tregohet se vendi ku janë pare:

Duel vajza në çerdak

Doli vajza në avli

A thu non e kam jazi

Informatori: S. M e lindur më 1955

Amvise

Mbledhës Afrim Jakupi

KËNGËT RRETH GRABITJES SË VAJZËS

Në vazhdim do sjellim një këngë rreth grabitjes së vajzës e cila u këndohet dy të dashuruarve, kur për arsye dhe rrethana të ndryshme nuk mund të ishin bashkë. Kur edhe shkuesi nuk mund të merrte lejen për fejesë dhe bashkimin e dy të rinjëve, atëherë djali detyrohej ta merrte e ta grabiste vajzën pa lejen e familjes së saj.

Po çna ke një ditë e shtun

Po çna ke një ditë e shtun
E na krisi ni uzbun
Ni uzbun e ni potere
Iku vajza ditën ndrek
Ditën ndrek sahati dy
Baba i vajzës sisht aty
Ka shku nlover me lavrue
I shkoj gjali tu piskllue
Për motrën i kish diftue
Gjer shkoj baba me kal
Vajza iku nGostivar
Gjer shkoj baba me xhip
Vajza iku n Padilisht

KËNGË PARAFEJESE

Këngët ne vazhdim janë këngë që i këndohen djalit për dëshirën e vetme të familjes, fejesën e djalit me një vajzë të vyrttyshme e të bukur nga fshati.

Ni moll e ni dardh e ni ftue

Ni moll e ni dardh e ni ftue o, eni ftue o

Kemi Lirim agën pa fejuë o , pa fejuet o

O pa feju nuk e lojna o, nuk e lojna

Ni nuse katundi do ja gjojna o, do ja gjojna

Edhe do ja gjojna ni sherete o, ni sherete o

Edhe do ja gjoje motra e vete o, motra e vete o

Edhe do ja gjojna ni qibare o,ni qibare o

Edhe do ja gjoje motra e madhe o, motra e madhe o

Në këtë këngë shprehet dëshira e motrës për fejesën e vëllait:

Edhe do ja gjojna ni sherete o, ni sherete o

Edhe do ja gjoje motra e vete o, motra e vete o

O nder ni dardh...

O nder ni dardhe kputa dardhe

Prit be lirim aga dardhen o
O une prita edhe e mora
Dinaren hanem ma të bardhen o
O nder ni moll kputa molle o
Prite be lirim aga mollen o
Une e prita dhe e mora
Dinaren honem ma te hollen o
O nder ni kumbull kputa kumblën
O prite Lirim aga kumllën o
O un e prita edhe mora
Dinaren hanem ma te bukren o

Në këtë këngë përshkruhet bukuria e vajzës, ku thuren epitete si e bukura, e bardha, e shtat-hollë, tregohen vendet, si p.sh. : të prita te molla, te dardha te kumbulla etj.

Thoshin e thoshin

Thoshin e thoshin Dinara nuk ban
Prej se lypem ne çeli argavan
Argavan çelen e çelën o
Gojat e dushmanve ju mshelën o
Argavan çelën e thahet o
Gojat e dushmanve ju ndalem o

Thoshin e thoshin Dinara nuk din

Prej se lypem na çeli trandafil

Trandafili çelën e çelën o

Gojat e dushmanve ju mshelen o

Trendafili çelën e thahet o

Gojat edushmanve ju ndalem o

Këngët në vazhdim janë këngë para fejese, në të cilat përshkruhet bukuria dhe tiparet e vajzës.

O un e prita edhe mora

Dinaren hanem ma te bukren o

Në vargjet e mëposhme shprehet qartë gëzimi...

Thoshin e thshin Dinara nuk ban

Prej se lypem ne çeli argavan

Informatore A.M , 1972,amvise

Në këngën në vazhdim na shfaqet guximi i djalit me revole në dorë duke i thënë vashës:

E kam mbush pishtollin po e mba në dor

Sun na ndajden mu e ty,

Mori vetull hollë

Dinara felloza

Dinara felloza shum na shajten o
Sonte mu e ty e sun na dajden o
Sun na dajden mu e ty ,
e mori vetull holl
E kam mbush pishtollin po e mba në dor
Sun na ndajden mu e ty,
Mori vetull zez
E kam mbush pishtollin po e mba në brez

Na kendan bilbili

Na kendan bilbili ne grillishte
Kemi fol ni nuse te hishme
Ni nuse te hishme, ni nuse ten alt
Dy- tri copa katunde na jan bo merak
Na jan bo merak a vetull holla
Lirim agën e dishnja, e mora
Naj jan ba merak oj goj bilbile
Lirim aga kemishen jeshile

Nga kënga shihet gëzimi i familjes se kanë fejuar djalin me vajzën më të bukur, të cilës i thurrin lavde për bukurinë e saj si vetull-hollë dhe me shumë krenari thonë:

Dy- tri copa katunde na jan bo merak

KËNGË KUR MERRET RRIZJA

Dy këngët në vazhdim janë këngë kur merret rizja. Në fillim i nxjerr në pah tiparet dhe bukuritë e vajzës, si: *Vetull o mari drapen o*, më pas përshkruhet vështirësit që kanë pasur deri sa është marrë rizja sepse gjithë thojshin se, *Thoshin Lirim ages nuk i apen o*. Dhe më në fund është habitur gjithë fshati, ku shprehet me vargjet: *Mbet ni katund me goj hapet o!*

Vetull o mari drapen o

Vetull o mari drapen o

Mbet ni katund me goj hapet o

Mbet ni katund me goj hapet o

Thoshin Lirim ages nuk i apen o

Vetull o mari drapen o

Ipshin o pa si mirshin o

Dinara felloze e dishin o

Ipshin e si kerkojshin o

Dinara fellozen e dojshin o

Informator: M , R,1972

Amvise

Ndash fol e ndash kuvenda

Ndash fol Dinara hanmi

Ndash na kuvenda

Ndash fol Dinara hanmi

Ndash na kuvenda

Çerapet e tua felloza

Erdhen ten a

Çerapet e tua felloza

Erdhen te na

Erdhen te na vetull holla o

Lirim agën e dishnja e mora o

Erdhen te na vetull holla o

Lirim agën e dishnja e mora o

Erdhen te na goj bilbile o

Lirim aga kemishen jeshile o

Ka dal hana re

Asaj ane oj

Thoni nuses jon

Le la dale oj

Informatore : M.R.1972

Amvise

KËNGË FEJESE

Fejesa një akt që i paraprinë martesës . Në kohët e kaluar fejesa bëhej zakonisht me anë të një ndërmjetësi (te njohur, si shkues, etj). Shkuesi si shenjë të fejesës së dy të rinjëve sillte nishanin te familja e djalit. Fejesat bëheshin në pranverë me këmbim të nishaneve (unazave dhe

një marhame e peshqeshe tjera).Fejesa zgjatnin varësisht si do merren vesht miqt në mes veti. Mund të zgjaste nga gjashtë muaj e më shumë. Gjatë kësaj kohe të dyja familjet bënin përgaditjet e nevojshme, vajza e përgadit pajën (çejzin), kurse familja e dhëndrit përgadit teshat dhe të gjitha përgaditjet tjera të nevojshme.

Në vazhdim do të parqes disa këngë fejes të mbledhura pikërishtë në këto treva të Malit të Thatë.

Kapërcente uji nder mollen

Kapërcente uji nder mollen

At si e dishim e folem

At si dishim me gjithë zemër

At na e kaba Allahi ember

At si e dish lirim aga vet

E kishim jazi e kishim kismet

Kapercente uji nder uren,

At si e dishim e murem

Ate si dishim pi vegjelie

Ate n aka pru Allahi ne shpie

Flutur flutur

Flutur flutur shkon nhava

Pata qejf me ndejt hala

Flutur flutur shkon nhava

Pata qejf me ndejt hala
Sa shum të donja oj Dinara, je ejona
Flutur flutur shkon perqet,
Pata qejf me ndejt sivjet
Lirim aga nuk më le, se sa shum do dojna
Oj Dinara je e jona.
Fluturo flutur shko per toke
Pata qef me ndenj me shoqe
Pata qef me ndenj me shoqe
Lirim aga sme lejonte.

Në këtë këngë fejese na paraqitet gëzimi familjar me rastin e fejesës së djalit dhe dëshira e vajzës ka qenë që ende të rri me shoqe, e cila shprehet me vargjet:

Oj Dinara je e jona.

Fluturo flutur shko per toke

Pata qef me ndenj me shoqe

Pata qef me ndenj me shoqe

Lirim aga sme lejonte.

E kallem oj lulije

E kallem oj lulije e kallem

T'fejuem oj lulie t'fejuem

Me shum sheret fejon nona,
Fejon nona djalin e vet.
Me shum dajre me shum dajre
Me shume sevda fejon baba,
Fejon baba gjalin e par.
Nuse lule shum te lavderojshin
A da dalesh oj lulie
Ashtu sin a thojshin,

Rreth e mrreth i rash Tetovës

Rreth e mrreth i rash Tetoves
Rreth e mrreth i rash Tetoves
E ta bleva oren e dores
E ta bleva oren e dores
Jalla jalla, sa te dojna
Jalla jalla, sa te dojna
Oj Dinara u bane e jona
Oj Dinara u bane e jona
Rreth e mreth i rash Gostivarit
Rreth e mreth i rash Gostivarit
E ta bleva jelekun prej ari

E ta bleva jelekun prej ari
Jalla jalla, sa tkam dashte
Oj Dinara eja tjetojm bashke.
Ky fustan po buzeqesh po bon lum
Kush e ka vesh.
Po thot lum kush , e vesh
Kjo Dinara si princesh.

KËNGA KUR PRITEN PETKAT

Fejesës i paraprin edhe disa zakone, siç është marrja e masës. Zakonisht në të kaluare 10 ditë para ditës së dasmës, vjehri , pra familja e dhëndërit shkon te miku për të marrë masën e petkave për t'i dërguar në terzi(rrobaqepës). Familja e nuses ja dhuron një jelek dhe një fustan si masë për veshjet tjera.

KËNGA E I

Dinara felloza jelek basem
Erdh ago baba ta pres masen
Da ti presim petkat
Ti bash me shendet
Erdh Lirim aga
Me familjen e vet.

KËNGA E II

Nuse felloza nder dy thona

A ni bone daret e jona

Daret e juja uni ju punaj

Per Vitin e Ri priqe da ju çaj

Daret e juja ju pqetiti

Edhe nja dy muj dju renditi.

Kënga e I dhe II janë këngë kur priten petkat, kur shkon ago baba (babi i dhëndrit) të marrë masën ashtu siç shprehet në vargje:

Erdh ago baba ta pres masen

Da ti presim petkat

Ti bash me shendet

KËNGËT KUR DËRGOHEN PETKAT

Dërgimi i petkave(teshave të nuses) varej nga dita e dasmës, nëse dasma bëhej të enjten, atëherë petka dërgoheshin të hënën.Nëse dasma bëhej të dielën atëherë petkat dërgoheshin të enjten, pra tri ditë para dasmës.Petkat e nuses varen në dhomë qe t'i shohin të ftuarit, e më pas ftoheshin petkaxhinjtë, mblidhej i gjithë fisi për të kënduar këngë e me def.

Ti çuem shiritat e zeza

Nuse lule ma ti mare era

...përcillen petkaxhinjtë nga familja e dhëndërit për te nusja. Dërgohej veshjea e nusërisë
(fustani i bardhë, stoli e dhurata tjera.)

KËNGA E I

Ti çuem shiritat e zeza

Nuse lule ma ti mare era

Ma ti mare era

Ti flaroje

Te oda me xhama ti shpaloje

Ti çuem shiritat , mbaj nuse mbaj

Ma ti veshe dikush qeter

Qaj nuse qaj

KËNGA E II

Ta çuem kullukun e dores

Lirimi ja ka çue fellozes

Ja ka çue felloze hajdie

Felloza me gajle le ma rrie

Se felloza te uni da vije

Ta çuem qystekun e qafes

Lirim aga ja ka çue vashës

Ja ka çue vashës hajdie

Vasha me marak le na rrie

Se vasha te uni da vije

Kënga I dhe II janë këngë që këndohen me rastin e dërgimit të petkave, ku nusen herë e quan lule e herë thëllëzë dhe i përshkruan veshjet dhe stolit e dërguara , si dymijat me shirita të zi dhe qystekun.

Ti çuem shiritat e zeza

Nuse lule ma ti mare era

Felloza me gajle le ma rrie

Se felloza te uni da vije

KËNGET E VAJIT TË ÇIKËS

Sipas traditës, vajza rri ulur në një skaj të odës e mbulon koken me një korpë (shami) të kuqe duke qarë. Këto këngë i këndojnë vajzat e fshatit,i këndojnë vajzës që shkon nuse. Zakonisht këndohen një ditë para dasmës, vashat e këndojnë duke ia kujtuar rininë e saj duke ia thënë, vargjet si më poshtë:

Lamtumirë shoqet e mia,

Lamtumir o bab e nan,

Lamtumir vllazni e motra.

Se pri nesër nkit shpi sjam

Ka dal Dinara ate bunari hajvalla

O vlla ma i madhi, hajvalla

o vlla se unë shkova

Lirim agën e dishnja e morra

Ka dal Dinar ate avlija.

Hajvalla oj shoqet e mija

Hajvalla oj shoqe se uni shkova

Lirim agën e dishnja e morra

O, e oo sa mir ju bana

KËNGET E DITËS SË DASMËS

Dasmat në të kaluarën fillonin të dielën në mbrëmje, mblidheshin të afërmit e dasmorit dhe e shënonin nisjen e dasmës, e cila vazhdonte me ditë të tëra. Këngët e dasmës janë zakonisht këngë të kënduar me shumë dashuri nga vajzat e fshatit, që u këndohej bukurisë dhe dashurisë së djalit dhe vashës.

Në vazhdim do të paraqesim këngë me motiv dasme nga kënga I deri te kënga XII të mbledhura në këto anë të Malit të Thatë.

Kënga e I

E shtruem unazen me lula,

Për ty jemi nis a fudulla

E shtruem unazen me besylek

Për ty jemi nis mare hyrmelek

Oj shamia e zez me pelesa

Çi kije si qan oj nan zeza

Çi kije si qan e pekatën

Nona mo, Dinara nuk vikaten

Nona da vikate artanicën

Kënga e II

De qese ka dera kujnicen.

Oj Dinara hanmi apo ritesh

Si do vish te na a mberzitesh

Si smberzitem se o dere huej

Se me kan te baba dal e luej

Ani dal e luej uni me çika

Tu fol e tu qesh kalon dita.

Ani dal e luej un me vajza

Tu fol e tu qesh kalon nata.

Kënga e III

Nanae nuses ti mos u mërzit

Do ta bimi bijen dit për dit

Ani dit për dit, haj për jav

Si ta çele gojën pak ma rrall

Ani jav për jav muj për muj

Le ta shohë si asht dera e huj

Ani muj për muj e mot për mot

Le ta shofe si o me komond.

Janë këngë martesore të dasmës. Te kënga e I dhe II, përshkruhet jeta e vajzës te shtëpia e vet dhe ende ndjehet si e vogla si e përkëdhelura e babit,ku thotë :

Se me kan te baba dal e luej

Ani dal e luej uni me çika

Tu fol e tu qesh kalon dita.

Kënga e IV

Mjedis vetullave t zeza ka bi ni ni nishan

Sa me dashuri u muert Lirim a sultan

Sa me dashuri e me gazeta

A i kemi fjalët e vërtetra

Sa me dashuri me letra tshkrume

A i kemi fjalët e vërtetume

Kënga e V

O sasht e mundur që të rriti nana

Oj Dinara si e pikun nga hana

O sasht e mundur që të rriti nana

Oj Dinara si e pikun nga hana

O sasht e mundur që të rriti baba

Oj Dinara o si e pikur nga havaja

O sasht e mundur që të rriti baba

Oj Dinara o si e pikur nga havaja

O sasht e mundur që të rriti tezja

Oj Dinara o si e pikun nga rezja.

Kënga e IV dhe V janë këngë që këndohen në ditën e dasmës. Në këto këngë, përshkruhet bukuria e vajzës, thurren fjalët nga më të bukura, si: vetull zezë, e pikur nga qielli, si reze dielli etj.

O sasht e mundur që të rriti baba

Oj Dinara o si e pikur nga havaja

Kënga e VI

Lut e lut baba Dinaren ri edhe sivjet

Jo jo babai i dashur i mbusha 20 vjet

Lut e lut baba Dinaren ri edhe sivjet

Jo jo babai i dashur i mbusha 20 vjet

Lut e lut nana Dinaren rri edhe ni muj

Jo jo nona e dashur jam e derës huej

Lut e lut nana Dinaren rri edhe ni muj

Jo jo nona e dashur jam e derës huej

Lut e lut vllau Dinaren rri edhe kit jav

Jo jo vellau i dashur Lirimi sme la.

Këngë dasme në formë dialogu mes babait, nënës , vëllait nga njëra anë dhe vajzës në anën tjetër, që shprehin dëshirën e familjes qe vajza të rri edhe sivjet e shprehur me vargjet: *Lut e lut baba Dinaren ri edhe sivjet*, kurse vajza i përgjigjet *Jo jo babai i dashur, i mbusha 20 vjet* .

Kënga e VII

Do i kallim fitilat e llëmbës

Do ja marim o mat mirën babës

Do i kallim fitilat e llëmbës

Do ja marim o mat mirën babës

O mat mirat baba i ka dy e

Njo ja marrim njo ja lam shpie

O mat mirat baba i ka dy e

Njo ja marrim njo ja lam shpie.

Këngë , duke iu drejtuar babait të nuses në formë të porosisë, me fjalët:

Do ja marim o mat mirën babës

O mat mirat baba i ka dy e

Njo ja marrim njo ja lam shpie

Kënga e VIII

Lirim agës sa i bojshin petkat

Dinara fellozes I bojn vetllat

Lirim ages sa I ban sahati

Dinara fellozes I ban shtati

Kënga në vazhdim është një këngë dasme ku përshkruhet bukuria e vajzës, vetullat, shtati dhe bëhet një krahasim mes djalit dhe vajzës me fjalët.

Lirim ages sa i ban sahati

Dinara fellozes i ban shtati

Kënga e IX

Hajde oj Dinara xhades reje

Hajde oj Dinara xhades reje

Oho xhades reje jalla un po vije

Oho xhades reje jalla un po vije

Oho shpin e Lirim ages nuk e dije

Oha shpin e Lirim ages nuk e dije

Shpia e lirim ages asht kollaje

Shpia e lirim ages asht kollaje

Oho me hyp mbrenda

Jalla si saraje

Oho me hyp mbrenda

Jalla si saraje

Shpia e Lirim ages te xhamija

Oho mbrenda jasht o po valzon rinia

Në këtë këngë përshkruhet bukurit e fshatit, shtëpia e dhëndrit e cila gjendet te xhamia dhe oborri si në saraje me vargjet:

Jalla si saraje

Shpia e Lirim ages te xhamija

Kënga e X

Kush po duket atje lart hej aman

Kush po duket atje lart hej aman

Lirim ag me dajallar hej aman

Lirim ag me dajallar hej aman

Dajallart flamur përpara hej aman

Dajallart flamur përpara hej aman

Lirim agën e marrt e mbara hej aman

Lirim agën e mbara e ka marr hej aman

Prej at dit nusen qe ka nxan hej aman

Prej at dit nusen qe ka nxan hej aman

Një këngë tipike vendase me flamur ku na përshkran edhe fisin e djalit,dajallarët duke uruar mbarësi nipit.

Dajallart flamur përpara hej aman

Lirim agën e marrt e mbara hej aman

Kënga e XI

Kallnja moj kallnja malin o

Na po martojna djalin o

Mali nuk po kallet o

Vallja jon nuk ndalet o

Mali nuk po kallet o

Vallja jon nuk ndalet o
Kallnja moj kallnja fushen o
Na po marim nusen o
Fusha nuk po kallet o vallja spo ndalet

Këngë dasme me vargje shumë të bukura e kuptimplota, Kjo këngë haset edhe në rajonet të ndryshme si në Pollog e gjetiu. Shprehet dëshira e zjarrtë për martesën e djalit ku thotë, “ le të ndizet mali, ne po martojmë djalin edhe sikur mali mos të ndizet vallja nuk do ndalet”.

Kënga e XII

Un në at koder, ti nket koder
Shum e mir Dinara, pak e vogël
Sjam e vogël jam tamame
E kam belin për kollan
Sjam e vogël jam sherete
E kam qafen për qysteke

Kënga është në formë të dialogut mes vajzës dhe djalit ku dialogojnë në mes veti. Djali i shprehet me fjalët: „ *Shum e mir Dinara, pak e vogël*“, kurse vajza i përgjigjet: „*Sjam e vogël jam tamame E kam belin për kollan*“.

Kënga e XIV

Hajde oj Dinara, hajt ten a e o
Ani kam shum shoqe,sdi kujt me ja lone o

Hajde oj Dinara,merri edhe ato e
Se kemi do djema, edhe do frajera o
Njonen pri atynje, vllait Lirimt bgjerja o

Preokupimi i vashës se ku do lerë shoqet, bëhet fjalë në këngën në vazhdim.

Informator: H.K (1970)

Amvise

Kënga e XV

Nuse felloze emen qeter
Qite terlikun e vjetër
Qite terlikun e babës
Se da e veshish terlikun e Lirim ages
E ka ungj nuse felloza
Shamien pqeposht
Qite shamijen oja
Qite shamijen e babes
Vene shamien e Lirim ages

Në fillim të këngës nusja thirret me epitete si thëllënzë, dhe i thuhet t'i nxjerë teshat e vajzërisë, tërlíkun dhe shamijen e babës, ta vesh tërlíkun e Lirim agës.

Informator H.K (1970), amvise

KËNGËT KUR ARIJNË KRUSHQIT NË SHTËPINË E NUSES

Dita e enjte është dita kur merrej nusja, pra dita e dasmës. Kurushqive u paraprinin dy burra bajraktarë dhe të gjithë krushqit tjerë vijnin pas në këmbë me brez e me plis në kokë.

Në vazhdim do të paraqesim disa këngë dasme kur krushqit arrijnë në shtëpinë e nuses.

KËNGA I

Mari nona ulurojshin kodrat o

Bije e nanës ti kan prutun lodrat o

Mari nona ulurojn sokaket o

Bija e nanës ti nkrehin bajraket o

Mari nona ulurojn ulicat o

Bij e nonës ti kan prut muzikat o.

Kënga është në formë monologue, ku nëna shprehet: “ po ulërinë kodrat e sokaket, bija e nanës t’i kanë prue lodrat”.

KËNGA II

Qan nuse molla oda dridhet o

Të mires pri shpie nuk i dilet o

Si do daesh o degae arres o

O si do daesh prej babes o

Si mjegulla kur çkpuet prej havajes o

Si do daesh o dega e thanes o

O si do daesh prej nanes o

Si mjegulla kur çkpuetet prej hanës o

Kënga paraqet momentetin më të dhimbshëm, ajo e ndarjes së vajzës me të afërmit nga familja e saj, grupi vajzave i këndon ndarjes nga babai.

Si do daesh o degae arres o

O si do daesh prej babes o

Më poshtë i këndohet edhe ndarjes nga nëna, me vargje aq të bukura:

Si do daesh o dega e thanes o

O si do daesh prej nanes o

Si mjegulla kur çkpuetet prej hanës o

KËNGA E III

Nuse lule a u bane gati

Na ka çue Lirima aga

Për nja gjys sahati

Nuse lule a u pregadite

Na ka çue Lirim aga

Për ni gjyms dakike

Kënga III është kënga kur krushqit kanë arritur te shtëpia e nuses. Hidhen valle, vashat i këndojnë nuses dhe e pyesin se a je përgatit se kemi arrdhur me të marrë. Shprehet me vargjet:

Nuse lule a u bane gati

Na ka çue Lirima aga

Për nja gjys sahati

KËNGA E LARGIMIT(NISJES) TË KRUSHQIVE

Këto këngë këndohen kur krushqit kthehen në shtëpi të dasmorit me nusen. I shprehet falemenderim krushkut (mikut) për mikpritjen dhe përcillet edhe me krisma pushkësh.

KËNGA E I

Qan nuse molla gjumonte o

Gjethin e malit e rrzonte e

Mo qaj nuse felloza ma gjuma o

Gjethin e malit a mos e rrza

At Albanin (një djal i vogël i familjes së nuses) mos e huta

Mos qaj nuse felloza ma bërtit

At Alban gjypin mos e çudit.

Në këtë këngë shprehet malli dhe vaj i vajzës kur del nga shtëpia e saj, edhe gjethet e malit bien edhe fëmijët e djepit frigohen nga piskama e saj.

KËNGA E II

Mari nusja jan ku na dole

Dylbera ngryk kan i morre

Edhe ku i morra ku si morra

Ma mbushën dullakun me morra.

Edhe ku i gjeta ku si gjeta

Ma mbushen dullakun me pqueshta.

Sipas traditave dhe zakoneve, vajza përshëndetet me farefisnin e vet para se me dalë nuse nga shtëpia e babait. Kënga që i këndohet e pyet pikërisht nusen për këto momente:

Mari nusja jan ku na dole

Dylbera ngryk kan i mor

Informator H.K (1970),amvise

Mbledhës Afrim Jakupi

KËNGA E KTHYERJES SË KRUSHQËVE

Janë këngë që këndohen në bazë të riteve që kryhen si zbritja e nuses në oborr të shtëpisë. Me të zbritur nusja më parë shkel në një tepsi (një nga zakonet që ende është shumë i pranishëm në disa fshatra te Dervenit të Shkupit), ku sipas riteve lidhet me sjelljen e begatisë.

KËNGA E I

Kush na hyn ka lomba

Da zdrisë si hona

Dinara felloza

Kush na hyn ka dera

Da zdrise si rrezja

Dinara sy zeza

Kush na hyn ka grilli

Da zdrise si dilli

Lirim trandafilli.

Kënga përshkruan momentet kur hyn në shtëpi të dhëndrit dhe zbret në obor, bukurisë së saj i thuren lavde me epitete si hëna e si reze dielli.

Kush na hyn ka dera

Da zdrise si rrezja

KËNGA E II

Kjo Dinar ani vajz e re

E la nonen me ardh me ne

Kjo Dinar ani vajz e bukur

E la babën e erdh si flutur

Kjo Dinar ani vajz e nalt

E la vllaun e erdh te na

KËNGA E III

Qysteku i qafës shum të paska hije

Fol oj Dinara fol e kujna ije

O as e nones e o as e babës

O jam syzeza o e Lirim agës

Kulluku i dorës sa të paska hije

Fol oj Dinara, fol e kujna ije

O as e vllaut, o e as motrës

O jam syzeza e Lirim agës

KËNGA E NUSËRIMIT

Këndohen kur nusja vishet me vello stoli e roba nusërie. Këngët që u këndohen janë plotë dashuri dhe shprehin lavde për çiftin.

KËNGA E I

Kush po vjen me buzt e kuqe

Kjo Dinara u bo nuse

Kush po vjen me temena

Kjo Dinara mashalla

Mari nuse lule sa e mira

Ni sy e ni vetull 1000 lira

Mari nuse lule sa e gjata

Ni sy e ni vetull 1000 marka

Lirika popullore e përshkruan në mënyrë shumë shumë të bukur, bukurinë e nuses shqiptare në mënyrë figurative ku e krahason bukurinë e saj me lira e flori.

Mari nuse lule sa e mira

Ni sy e ni vetull 1000 lira

KËNGA E II

Kush o aj që rri ne ode

O bilbil o bilbil o

Kush o aj që rri ne ode

O bilbil o bilbil o

Lirim ag dhonder i rie

O bilbil o bilbil o

Lirim ag dhonder i rie

O bilbil o bilbil o

E ku humbur beqarinë

O bilbil o bilbil o

E ku humbur beqarinë

O bilbil o bilbil o

Kush o kjo që rri ne kombe

O bilbil o bilbil o

Kush o kjo që rri ne kombe

O bilbil o bilbil

Kjo Dinara nuse reje

O bilbil o bilbil o

E la nonen erdh me neje

O bilbil o bilbil o

KËNGËT E SOFRËS

Një ditë pas dasmës, zakonisht në mbrëmje ftohet i gjithë fisi, nusja e re vendohet në tryezë njihet me familjen e burrit. Këngët e sofrës i karakterizon motivi i mirënjohjes ku dasmori në shenjë falemenderimi shtron një darkë të për të gjithë të afërmit. Këngë që këndohen me këtë rast janë nga më të ndryshmet duke fillau nga falemenderimi për gratë që kanë përgaditur ushqim deri te këngët që i kushtohen nuses.

U ngrit nsaba herët

E nftallo ni pet

Vashat e bajkallarve

Te na erdhën vet

Morra ibrikët shkova te kroji

Pruna aga babës uji te ftoet

Morra ibrikët nisa ka udha e madhe

Pruna hankonenjes uji taze.

KËNGËT E BULLAVE (PËRQESHJA E NËNËS DHE BABAIT TË NUSES)

Janë këngë plot humor që vihen në lojë familjarët e nuses dhe dhëndërit , këndohen nga të dyja palët nga vajzat e e reja. Përqeshen vjehrrri e vjehrra, por asnjëherë djali dhe nusja, përfundojnë me sharje e mallkime.

KËNGA E I

Ka marr nona e nuses ni dor me hi

E kërkon Dinaren nëper shpi

Bij mari bij çmu bone oj

Hajde nones ti e shtroja sofrën oj

Ka mar none nuses ni dor me Kasht

E kërkon Dinaren mbrenda e jasht

Bij mari bi çemu bone oj

Hajde nones ti e shtroja sofrën oj

KËNGA E II

Kur tet thonë aga baba nuse bam ni kafe

Ma i thue aga babës pa çon ata llafe

Kur tet thonë hankonenja nuse bam ni pet

Ma i thue hankonenjes del e bane vet

Kur tet thotë kjo Fatimja nuse

Vjen Medina ma i thuesh ksaj Fatimes

Lem vdiret nga shpija

Kënga në mënyrë satirike jep një porosi për nusen sesi duhet të sillet me vjehrrin dhe vjerën, të jetë tamam një nuse shtëpi, pa mos ua kthyer fjalën.

Kur tet thonë aga baba nuse bam ni kafe

Ma i thue aga babës pa çon ata llafe

Kur tet thonë hankonenja nuse bam ni pet

Ma i thue hankonenjes del e bane vet

KËNGA E IV

Baba i nuses nona nuses

Kan dal ne çardak

Pa zishin me njani qetrin

Banin si papagall

Babae nuses nona e nuses

Kan dal nkapixhik

Pa zishin me njani qetrin

Bonin si ata gjypt

Një këngë plotë satirë e humor e kënduar nga vajzat e fshatit ku përqeshen babai i nuses dhe nëna e nuses në prani të saj, dhe më në fund e detyrojnë nusen të bëjë temena, nëse ajo refuzon, këngët janë edhe më satirike, krahasohet me figura të ndryshme.

Baba i nuses nona nuses

Kan dal ne çardak

Pa zishin me njani qetrin

Banin si papagall

KËNGA E V

Na shkuem te shpia e nuses

O ni 100 veta

Ajo nona e nuses sall po hyn

E sall po del

Mjera un e mjera

Shyqerparja nuk mu del

Nona e nuses mos u ban budalle

Bone ni tepci ma te madhe

At her shyqerparja do na dale

KËNGËT E SYNETISË

Janë këngë që paraqesin gëzimin familjar me rastin e synetisë së djali të tyre. Në vazhdim do të paraqesim disa këngë të mbledhura në këtë vendbanim. Këngët këndohen nga vajzat e fshatit përcillen me dajre e tupana.

KËNGA E I

Hecën Lirim aga m patika

Da bojm synet me patika

Ani me muzikat e Shqipërisë
Do bohet synet djali i zotnisë
Ani me muzikat e Kososvës
Da bohet synet djali i nones
Ani me muzikat e Gostivarit
Da bohet synet gjali kapedanit.

Në këtë këngë tregohet se me rastin e synetisë së djalit, do ta veshin me tesha më të mira se bëhet synet djali i zotrisë, me rastin e dasmës do sjellin defa e tupana e muzikë nga Shqipëria e Kosova.

KËNGA E II

Da bojm synet Lirim agën
Në krye të shkollës
Mi gëzofsh petkat e rea
O biri i babës
Petkat e rea i gëzofsha o
Me non e me bab i gazmofsha o
Da bojm synet Lirim agën në krye te lombës
Mi gëzofsh petkat e rea
O biri i nones
Petkat e rea i gëzofsha o
Me non e me bab i gazmofsha o.

KËNGA E III

E more berber ku je nisur
Baba e Lirim agës me ka grishur
Me ka grishur me dy dega arre
Da bojm synet o djalin për malle
Me ka grishur me dy dega thone
Da bojm synet o gjalin e nones

KËNGA E IV

Vjen berberi pyetën gjalin
Ku ma ki konakun
Aqe posht te dera madhe
Ku nkrea bajrakun
Vjen berberi pyetën gjalin
Ku ma kie shtëpien
Aqe posht te dera madhe
Ku grisha miqsien.

Në këngën e III dhe të IV përshkruhet dasma e synetisë, i këndohet djalit për mall që ka nëna, ftesën që ua ka bërë farefisit, ardhjen e berberit dhe tregohet ku i gjendet shtëpia.

Këngët këndohen nga vajzat e fshatit përcillen me dajre, i këndon nëna djali

Informator: Sh.K (1977), amvise

KREU I KATËRT

IV. VESHJA E GRAVE NË FSHATIN GURGURICË

VESHJA TRADICIONALE E NUSES NË RAJONIN E MALIT TË THATË – FSHATI GURGURICË

Veshjet popullore shqiptare të kësaj ane të Malit të Thatë kanë një tradite të lashtë që e përbënë një pjesë të kulturës dhe artit, ku gjejmë edhe elemente të kulturës tradicionale shqiptare. Ashtu edhe siç thotë dr. Dritan Statovci: “ *Veshja popullore është refleks jo vetëm i gjendjes shoqërore dhe ekonomike të një vendi a populli, por për nga vlerat që ka është dëshmi e ndjenjës dhe e shijes estetike, pasqyrim i botkuptimit dhe i botës imagjinative të njerëzve që punonin dhe e mbanin* “ (Kërkime etnografike, f.49) .

Deri sot etnografia shqiptare ka regjistruar diku afër 140 foma të ndryshme të veshjeve tradicionale të ndara në dy grupe sipas gjinisë. Te veshja e burrave dallohen disa tipe: si veshja me dollamë, me brekesha (Malësia e Tiranës), fustanellë (Shqipëria e Jugut dhe rrethina e Prespës) dhe me tirqi (Tropoja, Puka, Kosovë, Rafshi i Dukagjinit, Maqedonia Veriperendimore), veshja me shallvare (Prizreni dhe Ulqini). Veshjen e grave e përbëjnë tipet me këmishë (Malësia e Gjakovës), brekesha, dhe veshja me xhubletë (Shqipëri).

“*Është dëshmuar se në kulturën popullore shqiptare ruhen gjurmë të lashta që lidhen gjenetikisht me kulturën ilire. Me ndihmën e veshjes kombëtare njeriu përfaqëson të vërtetën tradicionale. Veshja dëshmon se ku janë rrënjët në kulturën historike*” (Edibe Selimi-Osmani, 2014, f. 5)

Një vend të veçantë në jetën e banorëve të këtij fshati zë padyshim dasma, dhe me të drejtë banorët e këtij vendbanimi atë ditë kanë festë, ftohet i gjithë fshati. Ritet e dasmës e në veçanti veshja e nuses në Gurguricë kanë një traditë të hershme e kultivuar me shekuj brez pas brezi, duke futur edhe elemente të reja, por gjithmonë duke ruajtur origjinalitetin dhe traditën shqiptare, madje mbeten trashigimi shpirtërore e popullit shqiptar në këto treva. Dasmat ndodhin zakonisht gjatë muajve të verës kur ka një numër shumë të madh të banorëve pasi është kryesisht me një fshat mërgimtarësh dhe gjatë muajve të verës kthehen në familjet e tyre. Pra, dasmat bëhen zakonisht të enjten dhe të dielën sipas riteve e traditave që ruhen me shumë dashuri.



Pamje e fshatit Gurguricë

Ajo që bie në sy në dasmat e këtyre trevave dhe që e bën edhe më madhështore atë është mënyra e marrjes së nuses. Krushqive u prinë dy burra para bajraktarit, kurse krushqit tjerë vijnë në këmbë. Dasmori u ndanë të gjithë krushqive një plis, një brez dhe një bajrak (për të parin e krushqive) gjë që e simbolizon prezencën e riteve kombëtare dhe identitetin shqiptar.



Krushqit

IV.1 PUNIMI I VESHJEVE

E quajnë veshja e Malit të Thatë, pasi këtë veshje e bartin kryesisht gratë e vajzat e fshatrave të këtij rajoni.”Mbart në vete shumë vlera që ofrojnë studime të ndryshme, si p.sh në aspektin structural, morfologjik, artistik, tipologjik apo historik”(Statovci, 1988, f.49) etj

Nga ana strukturale përmbajtësore hasim motive me përmbajtje fitomorfe floreale (nga bota bimore) e shprehur me shumë në qendrisjen e këmishave, çorapeve etj. Motive zoomorfe (nga bota shtazore) si qendrisja e dallëndysheve, shqiponjave, fluturave etj.

Po ashtu edhe motivi antropomorf zë një vend të caktuar në veshjet e kësaj ane, si: p.sh. qendrisja e zemrave etj. Në veshjen popullore të kësaj ane një rol të rëndësishëm luajnë edhe ngjyrat dhe kuptimi i tyre.

Ato dallojnë në ngjyrë, pasi gratë e moshuara veshin ngjyrë më të errët, ndërkaq vajzat e reja dhe nuset ngjyra më të hapura, të cilat i punojnë gratë e këtij fshati me razbue, veku (tezgja) dhe i qëndisin vajzat.



Razbue,vek(Tezgja)

Eshtë mjet nga druri që shërben për endjen e brezave, këmishave etj, ky është vek horizontal.



Qendisja

IV.2 VESHJET DHE PREGADITJET E NUSËRISË

Edhe pse duket e thjeshtë, veshja e një kostumi si ky është shumë i nderlikuar. E gjithë procedura zgjat të paktën një orë.

Së pari, vishen: çulkat, kalçinat këmisha, amçaniku, jeleku, anteria, brezi, poshi, bafçarka, skepka me ruza, kallani me ruza, çeprazet, strimkat, telat, kllifat, kësula, korpa me oja.



Çulkat - vishen në fillim të veshjes i mbathin nusët e reja në raste solemne.

Struktura morfologjike : janë të punuara me thurje me krabëza me fije leshi por edhe pambuku, mund të përdoret edhe sërme. Gjatësia e çulkës arrin gjatësi 10-15 cm, me formë cilindrike me ngjyra të ndryshme, grykat punohen në tokçe. Pastaj fillon punimi i lules ose i trëndafilit, sipër çulkës vëndohen rrypa që punohen me ruza. Në çulkat vendosim amçarikun që shtrëngon mos rëshqas çulka.



(Çulkat)

Më pas vishen **kallçinat-çorapet** , të cilat janë mbathje e përditshme të punuar me krabëza me thurje fije me tel.

Struktura morfologjike: Kalçinat thuren me fije leshi, duke nisur nga gishtat. Punimi apo qëndisja bëhet i shumëllojshëm me rrush, me trëndafila, me medrra, me shqipe etj. Pjesa e sipërme quhet shark ku vendosen rypa. Kalçini vishet pas çulkave që vishen në fund të këmbës.

Motivi: në qëndisjen e çorapeve haset motivi floraol si i lules, motivi zomorfe si këmba, gjeli etj. Haset edhe motivi gjeometrik si i figurave.



(Kallçinat)

Këmisha: Është veshja e rradhës që vishet pas çulkave dhe kallçinave, këmisha endete në vek.

Struktura morfologjike: Këmisha është e gjatë 50-60 cm me grykë të hapur, vetëm punimi dhe pjesa e fundit e kemishës ka diku dyzet kinda në formë të konit. Sa më i madhe të jete numri i kindave aq më solemn është rasti ku do përdorej kemisha. Gjatësia dhe gjëresia e kemishës luan një rol të madh në renditjen e palëve. Këmishat i endin në vek gratë e fshatit, kurse me pas vijon procesi i punimit të pëlhurës, vizatimi i figurës (trendafilin) dhe qëndisjet, kurse të qafa dhe të mëngat e kemishës vendosen ruza.

Motivi të këmishat është florale ornamentike, kemi shumë qëndisje të luleve



Amçaniku punohet prej pëlhure i cili duhet të jetë i hollë në gjatësi deri në tri metra. Ai shërben për të lidhur këmishën, jelekun dhe anterinë.



Foto amçaniku

Poshi është pjesë e veshjes tradicionale, një lloj brezi, i cili endet në tezgja (razbue) me fije tela me ngjyrë të kuqe dhe të zezë. Gjatësia është diku 4 metër dhe gjërësia 20-30 cm. Në të dyja anët është i zbukuruar me tufa.



Poshi

Jeleku është një veshje tradicionale që vishet pas këmishës dhe poshit, ekzistojnë dy lloje të jelekut, jelek i qendisur me sërm (fije argjendi) të verdhë dhe të bardhë të zbukuruar me sumlla, toka, perveshka.

Struktura morfologjike: jeleku punohet në pëlhurë ose kadife, qëndiset e zbukurohet, me disa monedha argjendi të quajtura si pare. Po ashtu, jeleku zbukurohet me sëmbëlla të punuara nga fije argjendi.




Foto jeleku



Veshje e nuses me anterie të mirë

Anteria është veshja që e bën dallimin mes nuseve dhe vajzave. Secila nuse posedon nga nëntë anterie siç janë: *Anteria çileargovan, anteria e mire, anteria e kuqe e zezë, anteria me lara (laramane), selimije, selimije me shirita të bardhe, selimije me shirita të verdhe*. Një ndër anteriet më të rëndësishme është anteria e mirë e cila vishet kryesisht nga nuset ditën e dasmës, ndërsa vajzat vishen me *anteria çileargovan ose anteri të zezë*. Pra stausi martesor luan një rol kyç në veshjen e anterive.



Struktura morfologjike: anteria është veshja kryesore që vishet mbi këmishë punuar nga pëlhura, kadifeje e qëndisur me *sërm* (fije) ari dhe mëndafshi, zakonisht ka mënga të gjata. Me motive me përmbajtje fitomorfe floreale (nga bota bimore) me lule të vogla, trëndafila dhe me shirita të qëndisur.

Brezi, një veshje me funksione të shumta vendoset mbi këmbë dhe shërbenë për ta shtërnguar belin. Te grate kemi disa lloje brezash në varshmëri prej statusit që kanë. Brezin e zi e veshin vashat, brezin me kolorit ngjyrash e veshin nuset. Endja e brezit për nuse duhet të jetë tre krahë, me gjerësi 25 cm. Për një ditë mund të enden dy breza, ditën e parë enden kurse ditën e dyte mbështjelllet. Në disa krahina njihet edhe me emrin shokë (Rrethi i Drenicës).



Foto brezi

Struktura morfologjike: brezi endet në vek në razbua (tezgja) me fije nga mëndafshi dhe leshi (juna) me ngjyra të ndryshme. Dominojnë figurat gjeometrike, si drejtkëndësha e katrorë. Enden e brezit e bëjnë vajzat dhe gratë e fshatit, nuse dhe duhet të jetë tre krahë. Për një ditë mund të enden dy breza, ditën e parë enden kurse ditën e dytë mbështillet.



Punimi i brezit ne vekë

Bafçarka është pjesë e përparme e veshjes së nuses, punohen në razbua(tezgja) .

Struktura morfologjike e bafçarkës është: Në fillim endet në vek, pastaj qëndiset me fije pambuku dhe me fije sërm has (fije nga argjendi). Bafçarkat për rreth punohen me rruza. Ekzistojnë disa lloje të bafçarkave, si : bafçarka të bajrakt, të pqong me satlit, me ruza, bafçarka e madhe etj.



Pqongu



Bafçarka me ruza



Bafçarka e madhe

Bafçarka e madhe vishet pas tërlikut. Punohet në razbue ku endet, mbështillet dhe vejet vetëm me tel të bardhë, të kuq ose të verdhë. Bafçarka së pari vizatohet me lule e trëndafila, pastaj mbushet me juna ngjyra të ndryshme. Në fund të bafçarkës vendosim kokërra sipas lules, kurse anash vendosim tufka me ngjyra të ndryshme.

Terliku është i tëri pëlhurë e zezë, që qepet dhe vizatohen me ngjyrë të bardhë. Lulet dhe trëndafilat qëndisen me ngjyra të ndryshme, kurse pjesa tjetër qëndiset me ngjyrë të zezë. Në skajet e tërlikut bëhet një punim që quhet fir, kurse te krahët quhet dorka.




Tërliku


Pjesë tjetër e veshjes janë edhe skepkat, skepkat me rruza, rizet, kallani me roza, çepraze që njihen edhe si pjesë dekorative.

Motivet te tërliku: këtu bie në sy motivi floreal, pra ajo e luleve dhe e figurave gjeometrike.

Stolitë janë elemente dekorative që blihen të gatshme që i vëndojnë gratë e fshatit.




Skepkat blihen të gatshme dhe vendosen mbi bafçark. Në varshmëri nga ngjyra e shamisë i përshtatet edhe ngjyra e skepkave



Strimkat janë zbukurime që vendosin vetëm vajzat



Kallani dhe **Dullaki i kuq** ,vendoset vetëm atë ditë kur nusja zbret në shtëpinë e dhëndrit.



Kësula

Kësula është veshje tradicionale, e cila përbëhet prej parave të bardha dhe katarec (parat e verdha) dhe amçanik na shërben për ta forcuar kësulen.



Çapraze(Gela)

Çaprazet (Gelat) vendosen në bel
Elemente dekorative



Alltont (strimkat) punohen me rruza të mëdhaja e me gajtan dhe vendoset në fund të strimkës



Veshja e vajzave

Veshja e vajzave dallon nga veshja e nuseve. Vajzat, për dallim nga nuset, vishen me anterinë çileargovan ose anteri të zezë.



Veshje e nuses me aneri të mirë



Veshja e nuses me terlik

Veshje e nuses me terlik. Karakteristikë e kësaj veshjeje është se kjo veshje vishet kur nusja shkon te familja e saj, pra është një lloj mbulese popullore.



INTERVISTA

Punimi është bazuar në të dhënat e lokes Sahide e lindur më (1957) me profesion amvise, nga fshati Gurguricë, si dhe nga tri vajzat: Medine Muslija, Fatime Luta dhe Valbona Veseli (nxënëse të shkollës) ,të cilat u kujdesën në sigurimin e veshjeve dhe fotografitë.

Informator në rregjistrimin e këngëve:

Ilmije . K e lindur më 1965 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

S.M e lindur më 1955 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

A. M e lindur më 1972 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

M. R e lindur më 1972 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

H.K e lindur më 1970 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

Sh.K e lindur më 1977 në f. Gurguricë, me profesion amvise.

Mbledhës i këngëve Afrim Jakupi.

FJALORTHI

Për ta pasuruar leksikun në përgjithësi dhe gjuhën tonë letrare në veçanti na kërkohet t'i kushtojmë kujdes të folmes popullore, e cila është e pastër dhe e pasur me fjalë e shprehje të rralla. Gjatë përgatitjes së kësaj teze masteri kam hasur në terminologji të ndryshme, në emërtime të ndryshme.

Në vazhdim po ju sjell disa fjalë e shprehje të mbledhura:

Me kallëzue frazë, me i tregu;

Gban frazë, çfarë bën;

I grishur mb. i ftuar;

Ksollë, a. f. shtëpizë e mbuluar me kashtë ku ruhen bagëtitë;

Lale lule ndf. këngë lirike e dashurisë;

Ec pri ko frazë, eja kënde;

Qyrek emër, Lopatë;

Lam, avli. e. oborr;

Me iu ntekë fol. me iu kujtuar ;

Keka e. tezja;

Zhgja gdat tham frazë, shiko çfarë do të them;

Pqyska e. dredhëza;

Zdrise fol. Shndrit;

Shjen e. qen ;

Uni dishnja ta marr frazë, unë doja ta marr;

Përqet ndaj. lart;

Korpa e. Shami;

PËRFUNDIM

Në tekstet e këngëve nga rajoni i Malit të Thatë pasqyrohen ngjarje dhe parakalojnë personazhe me rëndësi nga e kaluara historike të këtij rajoni (siç është Kasam Qehaja), por edhe marrëdhënie intime të njerëzve të thjeshtë të popullit. Personazhet dalin me emrat e tyre, por ndodh shpesh që personazhet e këngëve fshihen pas emrave simbolikë, si: Dinara, Lulija ,aga, kapedani, dylberi etj. Në pjesën hyrëse paraqiten të dhëna për Komunën së Bervenicës e në veçanti për vendbanimet me popullsi shqiptare të këtij rajoni, më saktësisht për fshatin Gurguricë i cili është objekt studimi në këtë punim. Në territorin e Komunës së Bervenicës, kemi gjurmuar material për etnokulturën shqiptare të kësaj ane të Malit të Thatë. Personazhet e këngëve popullore të rajonit të Malit të Thatë lëvizin, kryesisht në rajonin e vet, dhe nga Reka e Epërme. Krijimtari gojore e rajonit të Malit të Thatë, edhe pse në numër të vogël, është një thesar i pasur që shquhet për cilësinë e lartë të teksteve. Me keqardhje mund të themi, se ky fond i pasur , nuk është mbledhur në tërësi. Vlen të theksojmë se kënga e dasmës dhe lirika popullore në përgjithësi, gjithnjë ka ndryshuar dhe është pasuruar me elemente të reja. Këngët filluan të ndryshojnë e të zëvendësoheshin mjaft emërtime e të futeshin mjaft të tjera si elemente të reja. Emra si “kali e karocë” u zëvendësua me “limuzinë” e shumë të tjera që filluan të futen si elemente të reja që filluan të përdreshin dhe që më përpara s’kishin qenë të traditës. Po të analizohen me kujdes nga përdorimi i fjalorit, qartë dallohen se cilat këngë kanë pësuar ndryshime dhe si janë kënduar më herët (si psh vello-duvak).

Për fund mund të themi se edhe pse një punë e vogël për tezë të masterit, shpresojmë që sado pak të peshojë në studimet e folklorit të gjuhës shqipe të rrethit të Malit të Thatë. Arritëm që t’i mbledhim dhe t’i sistemojmë diku 65 këngë nga lirika popullore, për ta ruajtur nga zhdukja , veshjen popullore të grave dhe të vajzave, si dhe ceremonitë e martesës në mes dy të rinjve.

Gurgurica edhe pse gjenden në një hapësirë të “izoluar” nga fshatrat për rreth, ka arritur ta ruajë dhe ta kultivojë brez pas brezi të folmen shumë të pasur dhe autoktone nga të parët e tyre, ka ruajtur me xhelozitë traditat e dasmave, ritet dhe zakonet dhe shumë pasuri tjera shpirtërore popullore.

LITERATURA

MURATI, Qemal. (2016), Hulumtime linguistike dhe kulturë- historike në etnoregjonin e Rekës së Epërme, Shkup.

MUSTAFA, Bukuriye. MURTEZANI, Izaim. USEINI, Rini. (2017), Gjurmëve të veshjeve popullore shqiptare në Maqedoni. Shkup.

BIDO, Agim. (1991), Arti popullor në veshje e tekstil, Tiranë.

STATOVCI, Drita. (1988), Kërkome etnografike, Prishtinë.

HALIMI, Kadri. (2000), Trajtime dhe studime etnologjike, Prishtinë.

Universiteti “Sh.Cirili dhe Metodi” Fakulteti filologjik. (1997), Letërsia gojore shqiptare I. Shkup.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë, (1997), Etnografia shqiptare, Tiranë.

BEXHETI, Vebi, XHAFERI, Hamit. IRAHIMI, Mustafa. (2008), Studime etnolinguistike, folklorike dhe sociolinguistike për kulturën shqiptare në Maqedoni, Tetovë.

UÇI, Alfred, (2021), Estetika e folklorit, Tiranë.

ADILI, Çeliku Luljeta. (2021), 100 Këngë dasmash, Shkup.

SELIMI, Edibe. (2012), Veshja autoktone e femrave të Rekës së Epërme. Tetovë.

SELIMI, Edibe. (2014), Veshja autoktone e meshkujve të Rekës së Epërme. Tetovë.

Grup autor. (1999), Veshje popullore shqiptare I, Tiranë.

IBRAHIMI, Mustafa. (2020), Atlasi dialektologjik i të folmeve shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Vëll II – Veglat tradicionale. Interlingua, Shkup.

NEZIRI, Zeqirja. (1997), Letërsia gojore shqiptare. Shkup.

Burime tjera:

https://www.stat.gov.mk/ZaNas_al.aspx

Anketa dhe intervista